



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:283153

Datë: 13.11.2024

Numri i dokumentit: 06446485

C.nr.554/23

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditëses Z.M.nga fshati L./Malishevë të cilën me autorizim e përfaqëson Jeton Idrizi avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "I." me seli në Prishtinë, me bazë juridike "Kompensim dëmi", vlera e kontestit 1,000.00 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 13.11.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSTATOHET** se paditësja Z.M.nga fshati L./Malishevë të cilën me autorizim e përfaqëson Jeton Idrizi avokat në Prishtinë", **e ka tërhequr padinë** që identifikohet në këtë gjykatë me shenjën C.nr.554/23 e datës 17.11.2023, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "I." me seli në Prishtinë, me bazë juridike "kompensim dëmi".
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja Z.M.nga fshati L./Malishevë të cilën me autorizim e përfaqëson Jeton Idrizi avokat në Prishtinë, me datë 17.11.2023 në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "I." me seli në Prishtinë, me bazë juridike "Kompensim dëmi", vlera e kontestit 1,000.00 euro.

Lidhur me padinë e parashtruar nga paditësja, gjykata me datë 17.09.2024 ka nxjerrë aktvendim për përgjigje në padi dhe të njëjtin ia ka dërguar të paditurës, e cila nga fletë kthesa rezulton se e ka pranuar atë me datë 25.09.2024 por nuk ka kthyer përgjigje.

Përfaqësuesi i paditëses, me datë 16.10.2024 e ka dorëzuar në këtë gjykatë parashtrësën për tërheqjen e padisë në këtë çështje juridiko-kontestimore, duke e njoftuar gjykatën se e tërheqin padinë me numër C.nr.554/23 dhe arsyeja e tërheqjes së padisë është se me të paditurën kanë arritur pajtim jashtëgjyqësor.

Gjykata vlerëson se konform nenit 3.1 të LPK-së, i cili i referohet parimit të disponibilitetit, palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat e parashtruara në procedurë kontestimore, përfshirë edhe tërheqjen e padisë, veprim ky i përcaktuar me dispozitën nga neni

261 par.1 të LPK-së, e cila parasheh që: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”*.

Bazuar në faktin se paditësja e ka tërhequr padinë para se e paditura ta paraqes në gjykatë përgjigjen në padi dhe në rastin konkret nuk kërkohet pëlqimi i të paditurës, atëherë gjykata vlerëson se janë përmbushur prezumimet procedurale për të vepruar konform dispozitës nga neni 261 par.3 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Prandaj duke u gjendur në një gjendje të këtillë, gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.554/23, datë 13.11.2024

G j y q t a r i
Petrit Curri

Udhëzim juridik: *Kundër këtij Aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa konform nenit 261 par. 4 të LPK-së.*